



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



## Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 6761/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

### V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji Evropian “Dukagjini” për periudhën tri vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Shkencat Administrative, BSc, 180 ECTS, (me specializime: Administrim Publik; Administrim Biznesi), maksimumi 160 student për vit akademik.
- II. Obligohet BPrAL Kolegji Evropian “Dukagjini”, që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- III. Obligohet BPrAL Kolegji Evropian “Dukagjini”, që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

BPrAL Kolegji Evropian “Dukagjini” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Shkencat Administrative, BSc, 180 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkencat Administrative	BSc	180	Mitasin Beqiri, Arta Mulliqi, dhe Agim Shaqiri

1/2

AKA ka organizuar vizitën në BPrAL Kolegji Evropian "Dukagjini" më 06.07.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Reinhard Meyers, dhe Rebecca Maxwell Stuart.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 28 Korrik 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e BPrAL Kolegji Evropian "Dukagjini", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Evropian "Dukagjini";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

